

-
=



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1218/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Ruzhdi Qehaja – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (LDK) dega në Kamenicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1218, Anr.1219, Anr.1220, Anr.1221, Anr.1222, Anr.1223 të datës 03.12.2013, të Ruzhdi Qehaja – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal (LDK) dega në Kamenicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: 1218, Anr.1219, Anr.1220, Anr.1221, Anr.1222, Anr.1223 të datës 03.12.2013, të Ruzhdi Qehaja – Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, në të cilat ankesa pretendon se dyshon për se ka pasur keqpërdorime dhe mungesë të votave.

- Në ankesën Anr.1218/13 të datës 03.12.2013, ka pretenduar se dyshon duke mos cekur arsyt.
- Në ankesën Anr.1219/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se votat e deklaruara të familjarëve mungojnë duke mos shtuar më tepër arsyt e pretendimeve ankimore.
- Në ankesën Anr.1220/13 të datës 03.12.2013 , pretendohet se, dyshoj bazuar në deklaratat e të afërmeve
- Në ankesën Anr.1221/13 të datës 03.12.2013, nuk ka parashtruar pretendime ankimore në lidhje me shkëljen e supozuar dhe kryesin e supozuar.
- Në ankesën Anr.1222/13 të datës 03.12.2013 pretendohet se deklaroi se më mungojnë votat .
- Në ankesën Anr.1223/13 të datës 03.12.2013 pretendohet se nuk janë deklaruar votat e të afërmeve.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Ruzhdi Qehaja– Kandidatë për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) , ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe munges të konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1218/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.